



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:208291

Datë: 07.08.2023

Numri i dokumentit: 04587438

C.nr.2976/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.A dhe V.A, që të dy nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Armend Krasniqi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ E..... ” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enxhi Abazi, zyrtare ligjore pranë të paditurës, me objekt kontesti kompensim dëmit, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 12.07.2023, të mbajtur me prani të paditësit të parë dhe përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 21.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësve A.Adhe V.A, që të dy nga Prishtina.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksident komunikacioni të datës 01.01.2015, nga baza e auto përgjegjesisë, t’ua paguaj shumat si vijon dhe atë:

Paditësit A.A:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 1,500.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 1,050.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 98.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 98.00€

Paditëses V.A:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej..... 1,500.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 1,065.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 98.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 147.00€

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, që për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë si në pikën -II- të këtij dispozitivi, paditësve t’ua paguaj kamatën në lartësi prej 8% në vit, dhe atë për dëmin material nga data e parashtrimit të kërkesës për kompensim dëmi tek e paditura, 19.01.2015, kurse për dëmin jo material nga data marrjes së këtij aktgjykimi, 21.07.2023, e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,188.50€, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, mbi shumat e aprovuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë për: paditësin A.A: për dhimbje trupore - fizike, shuma prej 2,500€, për frikën e pësuar, shuma prej 1,950.00€, për ushqim të përforcuar, shuma 702.00€, për përkujdesje të personit të huaj, shuma 902.00€ dhe për rehabilitim klimaterik dhe fizioterapeutik shuma 500.00€; Për paditësen V.A: për dhimbje trupore - fizike, shuma prej 2,500.00€, për frikën e pësuar, shuma 1,935.00€, për ushqim të përforcuar, shuma 602.00€, për përkujdesje të personit të huaj, shuma 853.00€ dhe për rehabilitim klimaterik dhe fizioterapeutik, shuma 500.00€.

A r s y e t i m

Paditësit A.A dhe V.A, që të dy nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 09.12.2015, në këtë Gjykatë, kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....”, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në padi, parashtrësat e dorëzuara në gjykatë, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se me datë 01.01.2015, në Prishtinë, më saktësisht rrugën “B.B” është shkaktuar aksident i komunikacionit rrugor, si pasojë e të cilit lëndime trupore kanë pësuar të dëmtuarit A.A dhe V.A. Tutje ka shtuar se në mes palëve ndërgjyqëse u sqarua baza juridike e kërkesëpadisë por se kontestuese edhe më tej mbetet lartësia e kërkesëpadisë së paditësve. Mbi bazën e këtyre, i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe ta obligojë të paditurën t’ua kompensojë dëmin si në vijim dhe atë për paditësin A.A: në emër të shkaktimit të dhimbjeve fizike shumën prej 4,000.00€; në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3.000€; në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 800.00€; në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 1.000€; në emër të shërimit klimaterik dhe fizioterapeutik shumën prej 500.00€ apo shumën e përgjithshme prej 9,300.00€. Për paditësen V.A: në emër të shkaktimit të dhimbjeve fizike shumën prej 4.000€; në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3.000€; në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 700€; në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 1.000€; në emër të shërimit klimaterik dhe fizioterapeutik shumën prej 500.00€ apo shumën e përgjithshme prej 9,300.00€. Të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8%.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 1,644.50€ dhe atë: 208.00€ për përpilim të padisë, 204.00€ për precizimin e kërkesëpadisë, 200.00€ për dërgimin e parashtrësive, 400.00€ për shpenzimet e ekspertëve mjekësor, 607.50€ për përfaqësimin e paditësit nga avokati në tri seanca gjyqësore.

E paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” Sh.A, në përgjigje në padi, në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por e ka kontestuar kërkesëpadinë vetëm për nga lartësia e dëmit me arsyetimin se bazuar në raportet mjekësore të dorëzuara në kompani, paditësit kanë pasur lëndime të lehta trupore dhe shumat e kërkuara janë të larta. Ka shtuar se paditësit kanë ushtruar kërkesë në procedurë të rregullt administrative për kompensim dëmi në ish Kompaninë e Sigurimeve “D.....”, tani Kompania e Sigurimeve “E.....”, e cila brenda afatit ligjor, ka kthyer përgjigje se kërkesa e tyre ka bazë për kompensim dhe me qëllim të arritjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore për të gjitha kategoritë e dëmit material dhe jo material, për paditësin A.Aka ofruar shumën prej 200.00€ ndërsa për paditësen V.A shumën prej 150€. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë pjesërisht duke refuzuar shumat e kërkuara mbi shumën e ofruar nga e paditura, bazuar në natyrën e lëndimeve të lehta trupore. Shpenzimet e procedurës ka propozuar që të aprovohen vetëm sipas suksesit të procedurës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Raportin e aksidentit me numër 2015-AC-0004, të datës 01.01.2015, përpiluar nga Policia e Kosovës, Kërkesën për zhdëmtim të dëmit jo material dhe material të dorëzuar në Kompaninë e Sigurimeve “D.....”, paraardhëse e të cilës është këtu e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....”, me datë të pranimit 19.01.2015, Kërkesën për rishqyrtim të vlerësimit të dëmit jo material dhe material të dorëzuar në Kompaninë e Sigurimeve “D.....”, paraardhëse, pasardhëse e të cilës është këtu e paditura “E.....”, me datë të pranimit 17.08.2015, Ekspertizën mjekësore të datës 05.04.2023 e punuar nga ekspertët Dr.Sami Deliaj- Ortoped dhe Dr. Shpend Haxhibeqiri-Psikiatër, si dhe: Për paditësin A.A: Raportin mjekësor me numër rendor 95, të datës 01.01.2015, lëshuar nga Qendra Klinike Universitare - Qendra Emergjente, Kërkesën datës 19.02.2015 për plotësim të dokumentacionit drejtuar përfaqësuesit të palës A.A, Njoftimin e datës 18.08.2015 mbi vlerësimin e dëmit të shkaktuar me datë 01.01.2015, për lëndën 118/2015, drejtuar përfaqësuesit të palës A.A, i datës 18.08.2015. Për paditësen V.A: Raportin mjekësor me numër rendor 94, të datës 01.01.2015, lëshuar nga Qendra Klinike Universitare- Qendra Emergjente, Raportin mjekësor të datës 08.01.2015, lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë “Aloka”, Kërkesën e datës 19.02.2015 për plotësim të dokumentacionit drejtuar përfaqësuesit të palës V.A, Njoftimin e datës 01.06.2015 mbi vlerësimin e dëmit të shkaktuar me datë 01.01.2015 për lëndën 118/2015, drejtuar përfaqësuesit të palës V.A.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha se bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pjesërisht e bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datën 01.01.2015, në rrugën “B.B” kishte ndodhur aksident komunikacioni mes automjetit të tipit Golf IV me targa të regjistrimit 01....., të cilin e drejtonte Argjend Hyseni dhe automjetit të tipit Daimler Chrysler me targa të regjistrimit 01-353-HI, të cilin e drejtonte A.A. Po ashtu mes palëve nuk ishte kontestues as fakti se shkaktar i aksidentit të komunikacionit, nga ka rrjedhur edhe dëmi, ka qenë drejtuesi i automjetit me numër të targave 01....., i siguruar tek paraardhësja e të paditurës, me policën e sigurimit numër 0005000516, e vlefshme deri më 10.02.2015.

Po ashtu, mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti se paditësit, në procedurë administrative, kanë parashtruar kërkesë për kompensim të dëmit të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 01.01.2015, si dhe fakti se Kompania e Sigurimeve “D.....”, paraardhëse e Kompanisë së Sigurimeve “E.....”, kishte ofruar vlerat përkatëse për kompensim.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kompensimit, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre.

Nga raportet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - Qendra Emergjente, me numër 94 dhe 95, të datës 01.01.2015, gjykata ka konstatuar faktin se në ditën e aksidentit, paditësit janë paraqitur pranë këtij institucioni shëndetësor, i cili ka evidentuar lëndimet e pësura të paditësve dhe të njëjtit kishin pranuar edhe tretman mjekësor.

Me raportin mjekësor të datës 08.01.2015, lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë “Aloka” për këtu paditësen V.A, gjykata ka konstatuar faktin se paditësja, edhe pas datës së aksidentit ka pranuar trajtim mjekësor.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë dhe psikiatrisë.

Eksperti ortoped, Dr. Sami Delijaj, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi A.A, si pasojë e aksidentit ka pësuar ka pësuar ndrydhje të regjionit të kokës dhe qafës, të cilat klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 48 orë, theks të veçantë në regjionin e kokës dhe qafës për çka dëshmon edhe dokumentacioni mjekësor. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh, gjatë të cilës periudhë është trajtuar me analgjetikë dhe imobilizim me qafore. Dhimbje me intensitet të ulët paditësi ka qenë prezentë në periudhë kohore prej 6 muajsh, herë pas here deri në aplikimin e terapisë kundër dhimbjeve e sidomos gjatë ndryshimeve klimatike, pozitive të detyruara dhe ngarkesave fizike. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 2 javësh, në kuptim të ndihmës së aktiviteteve të përditshme jetësore siç janë: ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 2 javë, i pasur me vitamina, minerale dhe proteina. Eksperti ka konstatuar se për

paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në kohëzgjatje prej shtatë ditësh, në vitin e parë pas aksidentit. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Për sa i përket paditëses V.A, Eksperti ortoped, Dr. Sami Delijaj, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses, ka konstatuar se paditësja, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore si ndrydhje e regjionit të kokës dhe qafës, ndrydhje në regjionin e gjoksit, të cilat klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Paditësja, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka përjetuar. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 48 orë, me theks të veçantë në regjionin e kokës, qafës dhe gjoksit. Paditësja ka përjetuar dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh, gjatë të cilës periudhë është trajtuar me analgjetikë dhe imobilizim me qafore. Dhimbje me intensitet të ulët paditësja ka përjetuar në periudhë kohore prej 6 muajsh, herë pas here deri në aplikim të terapisë, kryesisht gjatë ndryshimeve klimatike, pozitave të detyruara dhe ngarkesave fizike. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 jave, në kuptim të ndihmës të aktiviteteve të përditshme jetësore, si ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 2 javë, ushqim i pasur me proteina, minerale dhe vitamina. Eksperti ka konstatuar se për paditësen ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 10 ditësh. Eksperti ka konstatuar se paditësja nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Shpend Haxhibeqiri, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi A.A, si pasojë e aksidentit të shkaktuar, nuk ka përjetuar frikë primare. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 orë, nga momenti pas përfundimit të aksidentit e deri në përfundim të trajtimit në qendrën emergjente. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 javë, gjatë të cilës periudhë kanë vazhduar peripecitë si ndrojtja, frika, ankthi, pagjumësia herë pas here. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje prej një jave, herë pas here. Ndërsa për paditësen V.A, eksperti i psikiatrisë, pas ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugor nuk ka përjetuar frikë primare, por e njëjta ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët. Frikë sekondare të

intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 4 orësh, nga momenti pas përfundimit të aksidentit e deri në përfundim të trajtimit në qendrën emergjente. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 javë, gjatë të cilës periudhë kanë vazhduar peripecitë si ndrojtja, frika, ankthi, pagjumësia herë pas here. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje prej një jave, herë pas here.

Gjykata, ekspertizat mjekësore, atë të Ortopedisë dhe Psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, të punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadisë është në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe Ligjit Nr.04/L077 për marrëdhëniet e detyrimeve, e posaçërisht në dispozitat në vijim.

Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 159 të tij ka përcaktuar se “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Me nenin 137 të po këtij ligji përcaktohet se: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, gjykata gjen se pala e paditur është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar nga pala paditëse, mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia, konform nenit 136, 159 dhe 176 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, nenit 9, paragrafi 1.1 dhe nenit 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Andaj, gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit, posaçërisht duke marr parasysh

natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara nga paditësit, vlerësimin në ekspertizat mjekësore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesëpadinë e paditësve në shumë prej 1,500.00€, për secilin veç e veç, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar se paditësit A.Adhe V.A, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 01.01.2015, kanë pësuar lëndime trupore, të vlerësuara si lëndime të lehta trupore, dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar prej tij, kanë përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 48 orë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët në kohëzgjatje prej 6 muajsh, kohë pas kohe.

Në emër të kompensimit lidhur me frikën, për të dy paditësit, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,050.00€ për paditësin A.Adhe 1,065.00€ për paditësen V.A, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza nga lëmi i psikiatrisë është provuar se paditësi A.A, si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugor ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë rreth 3 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 javë dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe për një javë. Kurse paditësja V.A, ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë rreth 4 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 javë dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe për një javë.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin A.Adhe paditësen V.A, për secilin veç e veç, ka caktuar kompensimin në shumën nga 98.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësit kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 14 ditëve, i pajisur me proteina, minerale dhe vitamina.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata për paditësin A.Aka caktuar kompensimin në shumë prej 98.00€, ndërsa për paditësen V.A ka caktuar kompensim në shumë prej 147.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësit si pasojë e aksidentit, kanë pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, për shkak të paaftësisë së pjesshme, dhe atë paditësi A.Anë kohëzgjatje prej 21 ditëve, ndërsa paditësja V.A në kohëzgjatje prej 14 ditësh.



Gjykata, vlerëson se shumata e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'i mundësoj paditësve satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat janë privuar, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë e kujdes të huaj, dhe shpenzimet e shërimit, ka aprovuar shumata si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësve i'u takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësit për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësve i'u takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Këto kategori të kompensimit, janë të njohura edhe me Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga auto përgjegjësia, e cila nuk është obliguese për gjykatat në rastin e vendosjes, por mund të merret si kriter orientues, rezulton se kompanitë e sigurimeve në rastet e aksidenteve të komunikacionit, të dëmtuarve u njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë.

Gjykata, ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve që ndërlihet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi

përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë përtej shumave të gjykuara: Për paditësin A.A: në emër ushqimit të përforcuar shumën prej 702.00€, në emër të për kujdesit të personit të huaj (personit të tretë) shumën prej 902.00€ dhe në emër të rehabilitimit fiziko – psikik shumën prej 500.00€. Për paditësen V.A: në emër ushqimit të përforcuar shumën prej 702.00€, në emër të për kujdesit të personit të huaj (personit të tretë) shumën prej 853.00€ dhe në emër të rehabilitimit fiziko – psikik shumën prej 500.00€. Kjo pasi që në vlerësimin e gjykatës, bazuar në ekspertizën mjekësore të datës 05.04.2023, shumat e gjykuara për kategorinë e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për për kujdes të personit të huaj, janë në harmoni me qëllimin e kompensimit, dëmin e pësuar nga paditësit, kohëzgjatjen dhe praktikën gjyqësore për këtë lloj kompensimi. Kurse sa i përket kompensimit të dëmit material për rehabilitimit fiziko – psikik, gjykata, bazuar në nenin 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka refuzuar kërkesëpadinë për rehabilitim për të dy paditësit, për secilin nga 500.00€, sepse nuk janë ofruar prova mbi bazën e të cilave do të provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësit i takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata, për dëmin material fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së kërkesës tek e paditura (ish Kompania e Sigurimeve “D.....”, tani Kompania e Sigurimieve “E.....”, datë 19.01.2015, ndërsa për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 21.07.2023, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449, 452 dhe 453 të LPK-së, sipas të cilave paditësit u pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 1,188.50€ dhe atë: në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 156.00€, për pjesëmarrje në tri seanca gjyqësore të mbajtura shumën 607.00€ (3 seanca nga secila seancë nga 202.50€), për taksë për padi shumën prej 25.00€ dhe për ekspertiza mjekësore shumën prej 400.00€.

Gjykata nuk ka njohur shpenzimet e procedurës mbi shumën prej 1,188.5€ e deri në 1,644.50€, apo shumën prej 456.00€, bazuar në suksesin e palëve në procedurë, i përcaktuar me dispozitën e nenit 452, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, pasi që paditësit

pjesërisht kanë pasur sukses. Shumat e aprovuara nga gjykata janë nën vlerën 10,000.00€ të kontestit, ashtu që shpenzimet lidhur me përpilimin e padisë dhe përfaqësimin e paditësve janë njohur sipas tariforit 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, për vlerat e kontestit deri në 10,000.00€, për përfaqësim të dy paditësve nga avokati. Po ashtu gjykata nuk ka njohur edhe shpenzimet e kërkuara në shumë prej 204.00€ për parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadisë dhe 200.00€ për parashtrësa, bazuar në nenin 453 të LPK-së, pasi që në vlerësimin e gjykatës ky kompensim është konsumuar me njohjen e shpenzimeve për padi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr. 2976/15, me datë 21.07.2023

Gjyqtari  
Nexhat Qallapeku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.